

Ese: Heshtja përballë bullizmit-formë e pajtimit me këtë fenomen

“Ti interesohesh për ndjenjat e njerëzve të tjerë. Je kaq i sjellshëm dhe ka kuptim. Sepse ne jemi gjithnjë në dhimbje, ne e dimë ekzakhtësisht çfarë do të thotë të lëndosh dikë..”-Mieko Kawakami, Qiell

Në oborrin e shkollës sheh një moshatar të rrethuar nga të tjerë që e ngacmojnë; në rrugë dëgjon se si tallen me dikë që nuk e njeh; nëpër komentet pafund të rrjeteve sociale vëren se si njerëzit ofendojnë njëri-tjetrin...Mund të vazhdojmë të përmendim situata të tilla pafundësisht, sepse janë të pranishme në të përditshmen tone, sidoqoftë emëruesi i përbashkët në të gjitha do të ishte heshtja. Bullizmi është një fenomen që haset rëndom, sidomos në jetën e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe shfaqet në forma të ndryshme. Cilatdo qofshin këto forma, kjo dukuri është gjithnjë e dukshme. Pse më së shumti zgjedhim të heshtim dhe cilat janë pasojat e kësaj zgjedhjeje? A është indiferentizmi ndaj bullizmit po aq i keq sa vetë akti?

Ka shumë arsye që ndikojnë në zgjedhjen tonë për të heshtur kur dëshmojmë një situatë të bullizmit. Psikologët dhe studiuesit pranojnë se nuk është e lehtë të hidhet dritë mbi motivimet e brendshme të individëve për të reaguar me empati ose jo. Një nga arsyet më të pranuar është frika nga përfshirja në të njëjtën situatë me viktimën. Shumica e fëmijëve apo adoleshentëve i tremben idesë se reagimi aktiv ndaj bullizuesit do t'i rrezikonte edhe ata të binin pre e veprimeve apo fjalëve të tij.

Një tjetër arsye që konsiderohet e vlefshme është kultura e tolerancës ndaj dhunës. Mjedisi ku secili prej nesh është rritur ndikon në perceptimin tonë për çdo dukuri, përfshi këtu edhe bullizmin. Individët e rritur në një ambient me kulturë që toleron dhunën, nuk mund ta shohin bullizmin si një problem madhor, për rrjedhojë zgjedhin të heshtin në vend që të reagojnë kundrejt një situatë të tillë. Rasti më i keq, përmbledh ata që zgjedhin indiferencën thjesht sepse besojnë se nuk ia vlen të shqetësohesh për problemin e dikujt tjetër, apo në rastin më ekstrem, ata që e mbështesin bullizmin si akt.

Në librin “Qiell”, shfaqet qartazi se shpesh, arsyet pse bullizuesit bullizojnë, janë të cekëta, po aq sa dhe arsyet pse “kalimtarët” heshtin.

“Disa njerëz thjesht mund të bëjnë gjëra e të tjerë s'munden. Ka gjëra që ata duan t'i bëjnë e të tjera që s'duan. Secili ka pëlqimet dhe mospëlqimet e veta. S'mund të jetë më e thjeshtë se kaq. Njerëzit bëjnë atë gjë nga e cila e dinë se mund të dalin pa u lagur.”-Momose u shtriq.-

“Asgjë nga këto ama nuk ndodh për ndonjë arsye. I bëjmë ato gjëra pa ndonjë arsye. Mundemi dhe i bëjmë. Dhe ti s'mundesh. Dhe as për këtë nuk ka ndonjë arsye.”

Sidoqoftë, ky nuk është gjithmonë rasti. Shpesh arsyet për bullizmin lidhen me trauma të së kaluarës e motivime më të thella, ashtu sikurse mund të lidhen edhe arsyet që cojnë në heshtje.

Heshtja përballë këtij fenomeni mund të shkaktojë pasoja tronditëse në jetën e viktimave. Sa adoleshentë sot përjetojnë probleme si ankthi ose depresioni për shkak se kanë humbur shpresën për jetën? Sa të tjerë nuk arrijnë të duan vetveten, sepse besojnë fjalët e mbushura me urrejtje që dëgjojnë nga moshatarët e tyre?

“Në fillim, vetëvraska ishte thjesht një fjalë, një ide e mjegullt e ndarë nga realiteti. Tregonte një mënyrë se si njerëzit e tjerë zgjidhnin të vdisnin, njerëz që unë as që i njihja. Kur kjo fjalë u bë e imja, mori formën më të çuditshme. Mund ta ndjeja që rritej brenda meje. Vetëvraska nuk ishte më dicka që u ndodhte të huajve. Unë mund ta bëja të ndodhte po të doja.”- Kështu shprehet viktima kryesore e bullizmit të “Qieit”. Është shkundëse, e vështirë për t’u përtypur dhe aspak e rehatshme për t’u menduar, por është e vërteta e shumë të prekurve të tjerë me të cilët ndeshemi çdo ditë.

Në një dukuri si bullizmi, që ka fuqinë të shkatërrojë jetë fëmijësh e adoleshentësh, të përmbysë të ardhme njerëzish, heshtja bëhet automatikisht pajtim, sepse heshtja përballë zhbërjes së vlerës së individit, nuk mbetet në rrafshin e mungesës së kundërshtimit, por arrin nivelin e miratimit.

Kështu kthehet në detyrë njerëzore të gjithsecilit prej nesh të mos mjaftohemi vetëm me idenë se nuk jemi ne ata që bullizojmë, por të kemi përgjegjshmërinë morale, ndërgjegjen dhe guximin për të ngritur zërin dhe për të ndryshuar atë që është e papranueshme.

Arsyet që çojnë në indiferentizëm janë të vlefshme, e megjithatë nuk vlejnë si justifikim përballë dëmit që ky fenomen shkakton. Për hir të humanes, të kesh forcën të kundërshtosh hapur një individ që bullizon është lartësim i karakterit. Ligji i pashkruar, e megjithatë i patjetërsueshëm: Të kesh në dorë të bësh të mirën dhe të mos e bësh, është po aq e gabuar sa të bësh të keqen.

Kologji Preka, Korçë

Katerina Drabo